

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikagard®-720 EpoCem®

MIKRO-LLAÇ PREJ 3 PËRBËRËSISH ME BAZË ÇIMENTOJE DHE EPOKSIDI PËR IZOLIM SIPËRFAQESH



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-720 EpoCem® është llaç me 3 përbërës, me bazë çimentoje, i modifikuar me epoksid, tiksotropik dhe me teksturë të imët për nivelimin dhe finirimin e sipërfaqeve prej betoni, llaçi ose guri.

### PËRDORIMET

- Si shtresë niveluese mbi betonin dhe llaçet në 0.5-3 mm mbi sipërfaqe vertikale ose horizontale.
- Aplikim në punime të reja ose beton të dëmtuar, në mjedise kimike agresive
- Aplikim mbi nënshtresa me përmbajtje të lartë lagështie, edhe mbi beton i cili sapo ka fituar rezistencat (green concrete)
- Si një barrierë e përkohshme lagështie (Temporary Moisture Barrier, TMB) (min. 2 mm trashësi) duke lejuar aplikimin e veshjeve prej rrëshire epokside, poliuretani dhe PMMA\* që kërkojnë nënshtresa të thata, për një zgjidhje afatgjatë.
- Si izolues poresh për riprofilizimin, lëmimin dhe nivelimin e sipërfaqeve prej betoni
- I përshtatshëm për kontroll të lagështisë (Parimi 2, metoda 2.3, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, metoda 3.1 dhe 3.3, EN 1504-9).
- I përshtatshëm për rezistencë fizike (Parimi 5, metoda 5.1, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për ruajtje ose restaurim të pasivitetit (Parimi 7, metoda 7.1 dhe 7.2, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rritje të qëndrueshmërisë (Parimi 8, metoda 8.3, EN 1504-9)

\* Shih shënimet mbi Aplikimin / Kufizimet

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë kimike e përmirësuar në krahasim me llaçin PCC
- Mbrojtje e shkëlqyer e betonit në mjedise agresive
- Markë CE sipas EN 1504 pjesët 2 dhe 3
- I papërshkueshëm nga lëngjet, por i përshkueshëm nga avujt e ujit
- Ngjitje e shkëlqyer mbi betonin i cili sapo ka fituar rezistencat (green concrete) ose të ngurtësuar, qoftë ky i lagësht ose i thatë
- Mbiveshje e shpejtë e produkteve për finirim Sika® me bazë rrëshire
- Përgatitje ideale për finitura të lëmuara sipërfaqesh
- Për përdorim të brendshëm ose të jashtëm
- Nuk përmban tretës
- Mund të aplikohet manualisht ose mekanikisht

### MIRATIME / STANDARDE

- Testime kualifikimi në përputhje me Swiss Standard SIA 162/5, Ref. A-29'212-1E, data 26 shtator 2005 nga LPM AG, Beinwil am See, Switzerland
- Sistem për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit me metodën e veshjes sipas EN 1504-2:2004, mbart markën CE
- Produkt për riparimin strukturor dhe jo strukturor të betonit sipas EN 1504-3:2005, mbart markën CE

## INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Llaç me bazë çimentoje i modifikuar me epoksid		
<b>Ambalazhi</b>	Set 21 kg		
	Përbërësi A	shishe plastike 1.14 kg	
	Përbërësi B	bidon plastik 2.86 kg	
	Përbërësi C	thes 17 kg gati për përzierje	
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Përbërësi A-rrëshira	lëng i bardhë	
	Përbërësi B - forcuesi	lëng i verdhë transparent	
	Përbërësi C - mbushësi (filler)	pluhur agregatesh	
	Ngjyra përfundimtare	gri mat	
<b>Jetëgjatësia</b>	Përbërësi A, përbërësi B	12 muaj	
	Përbërësi C	9 muaj	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të padëmtuar dhe të vulosur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Përbërësi A, përbërësi B: Të mbrohet nga ngrica Përbërësi C: Të mbrohet nga lagështia		
<b>Dendësia</b>	Përbërësi A	~1.05 kg/l	(EN 1015-6)
	Përbërësi B	~1.03 kg/l	
	Rrëshira e përzierë	~1.30 kg/l	
	Përbërësit A+B+C të përzierë:	~2.00 kg/l	
	Të gjitha vlerat e dendësisë në +20°C		

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Rezistenca ndaj ngjeshjes</b>	> 45 N/mm <sup>2</sup> (28 ditë / +20°C / 50% lagështi relative) (Kategoria R4 sipas EN 1504-3)	(EN196-1)
<b>Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje</b>	> 5 N/mm <sup>2</sup> (28 ditë / +20°C / 50% lagështi relative)	(EN196-1)
<b>Koeficienti i zgjerimit termik</b>	~13 × 10 <sup>-6</sup> 1/K	
<b>Reagimi ndaj zjarrit</b>	Kategoria A2(fl) S1	(EN 13501-1)
<b>Rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje dhe kripërave akullshkrirëse</b>	Faktori i rezistencës WFT-99 % (i lartë)	(EN 196-1)
<b>Rezistenca ndaj sulfateve</b>	Rezistencë e lartë ndaj sulfateve	(ASTM C 1012)
<b>Rezistenca ndaj difuzionit të dioksidit të karbonit</b>	μCO <sub>2</sub> ~5400	(EN 1062-6)
<b>Temperatura e funksionimit</b>	-30 °C min. / +80 °C max. për ekspozim të vazhdueshëm	

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

Duhet të zbatohet plotësisht siç përshkruhet struktura e sistemit dhe nuk duhet ndryshuar.

**Lyerja me prajmer tregohet më poshtë dhe është e përshtatshme për secilën nga nënshtresat e mëposhtme:**

- Betoni cili sapo ka fituar rezistencat (green concrete) (kur të jetë e mundur përgatitja mekanike)
- Beton i lagësht (> 14 ditësh)
- Beton i vjetruar dhe i lagësht (lagështi në ngjitje)

**Mbushje vertikale ose horizontale poresh, riparim dhe nivelim:**

Trashësia e shtresës	0.5–3 mm
Prajmer	Saturim me ujë dhe paraqitje mat të lagësht
Suva	Sikagard®-720 EpoCem®
Veshja përfundimtare	Mund të lihet pa veshje ose mund të përdorni produktin e përshtatshëm nga seria Sikafloor® dhe Sikagard® sapo lagështia e sipërfaqes së Sikagard®-720 EpoCem® të ketë arritur 4%

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

### Raporti i përzierjes

Përbërësi A:përbërësi B:përbërësi C-përmasa e ambalazhit: 1.14 : 2.86 : 17kg  
Raporti i përzierjes: 1 : 2.5 : 14 - 15 (për peshë)

### Konsumimi

**Llaç dyshemeje / llaç / suva:**

~2.0 kg/m<sup>2</sup>/mm

Kjo vlerë është teorike dhe nuk përfshin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

### Trashësia e shtresës

Min.: 0.5 mm / Max.: 3 mm

Zonat e vogla të mbyllura dhe të izoluara (< 0.01 m<sup>2</sup>) deri në 5 mm

### Temperatura e mjedisit

+8 °C min. / +30 °C max.

### Temperatura e nënshtresës

+8°C min. / +30°C max.

### Koha e punueshmërisë

**Temperatura**

+10°C

+20°C

+30°C

**Koha**

~80 minuta

~40 minuta

~20 minuta

Set 21 kg

### Koha e pritjes / mbiveshja

Sapo Sikagard®-720 EpoCem® të mos jetë i ngjithshëm, mund të aplikoni veshje izoluese të papërshkueshme nga avujt.

Për aplikimin e veshjeve të papërshkueshme nga uji mbi Sikagard®-720 EpoCem®, lini lagështinë e sipërfaqes të bierë nën 4%, jo më herët se:

**Temperatura**

+10°C

+20°C

+30°C

**Koha**

~60 minuta

~15 minuta

~8 minuta

### Metoda e maturimit

**Temperatura**

+10°C

+20°C

+30°C

**Tharja e plotë**

~14 ditë

~7 ditë

~4 ditë

Shënim: Të gjitha kohët e tharjes jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtresës dhe ambientit.

# UDHËZIME APLIKIMI

## CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa e betonit duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj ngjeshjes (min. 25 N/mm<sup>2</sup>) me rezistencë min. ndaj tërheqjes 1.5 N/mm<sup>2</sup>.

Nënshtresa mund të jetë e lagësht, por nuk duhet të ketë ujë të grumbulluar dhe ndotës si vaji, grasoja, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj.

Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

Nënshtresat prej betoni duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive ose pajisje shkrifërimi për të hequr qumështin (koren e çimentos) dhe për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur. Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet mbi sipërfaqe, si vrimat dhe hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht.

Riparimet mbi nënshtresë, mbushja e vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të kryhen duke përdorur produktet e përshtatshme nga seria e materialeve Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®. I gjithë pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë ose fshesë thithëse elektrike.

## PËRZIERJA

Përpara përzierjes, tundni përbërësin A (lëng i bardhë) derisa të homogjenizohet, pastaj hidheni brenda enës së përbërësit B dhe tundni mirë për të paktën 30 sekonda. Kur nxirrni dozat prej fuçive, përziени dhe homogjenizoni më parë.

Hidhni binderin (lëndë lidhëse) e përzierë (A+B) brenda një ene të përshtatshme për përzierje (me kapacitet rreth 30 litra) dhe shtoni gradualisht përbërësin C ndërsa përziени me mikserin elektrik. Përziени plotësisht për 3 minuta derisa të arrihet një përzierje e njëtrajtshme pa kokrriza.

Përziени vetëm njësi të plota të përbërësve A+B+C. Mos përziени sasi më të vogla. Mos shtoni ujë.

### Veglat e përzierjes

Përziени me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300-400 rpm) me lopatë helike ose pajisje tjetër të përshtatshme.

Për përzierjen e 2-3 thasëve menjëherë, është gjithashtu i përshtatshëm mikseri me rrotullim tek ose antiorar (lloji me kosh) dhe me veprim të detyruar (lloji me kovë). Nuk duhet të përdoret mikser me rënie të lirë.

## APLIKIMI

### Aplikim manual:

Vendosni Sikagard®-720 EpoCem® e përzierë mbi nënshtresën e lagësht-mat dhe përhapeni në mënyrë të njëtrajtshme në trashësinë e kërkuar me një mallë ose shpatull. Nëse nevojitet, mund të përfundoni me një furçë ose sfungjer të lagësht neopreni.

### Aplikim mekanik:

Vendosja mbi sipërfaqe mund të bëhet gjithashtu me një pistoletë me hinkë ose me teknikën e spërkatjes së

lagësht. Për shembull një pistoletë Aliva Hopper, një Putzmeister S-5 ose një Graco T-Max 405. Kërkohe të vijoje finiturë manuale.

Mos përdorni ujë shtesë, i cili do të pengojë finiturën e sipërfaqes dhe do të shkaktojë çngjyrosje.

Sikagard®-720 EpoCem® i freskët duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 24 orë.

Sapo Sikagard®-720 EpoCem® të mos jetë i ngjithshëm, mund të aplikoni veshje izoluese të përshtatshme nga avujt. Verifikoni gjithmonë se lagështia e sipërfaqes < 4% kur aplikoni veshje të papërshtatshme nga avujt. Mund të arrihet një finiturë pa bashkime nëse ruhet një skaj i lagësht gjatë aplikimit.

### Shënim:

Sikagard®-720 EpoCem® mund të aplikohet mbi beton green ose të lagësht, pa ujë të grumbulluar mbi sipërfaqe.

Megjithëse produkti mund të aplikohet mbi sipërfaqet e betonit green (> 24 orë), këshillohet të lejoni të paktën 3 ditë që të ndodhi tkurrja e hershme e betonit, që të parandaloni shfaqjen e plasaritjeve nga tkurrja e betonit mbi sipërfaqen e llaçit/suvasë.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Siguroni gjithmonë ventilim të mirë kur përdorni Sikagard®-720 EpoCem® në vend të mbyllur, për të larguar lagështinë e tepruar.
- Sikagard®-720 EpoCem® i freskët i aplikuar duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Për aplikime të jashtme, aplikoni prajmer dhe Sikagard®-720 EpoCem® gjatë rënies së temperaturës. Nëse aplikohet gjatë rritjes së temperaturës, mund të shfaqen vrima të vogla.
- Fugat jolëvizëse të ndërtimit kërkojnë trajtim paraprak me një shirit veshjeje me prajmer dhe Sikagard®-720 EpoCem®. Trajtoni si më poshtë:

Plasaritje statike	Mbushini dhe niveloni me Sikadur® ose rrëshirën epokside Sikafloor®
Plasaritje dinamike (> 0.4mm)	Të vlerësohet në kantier dhe nëse nevojitet aplikoni një shirit veshjeje prej materiali elastomer ose të projektohet si fugë lëvizjeje

- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në ulje të kohës së shërbimit dhe plasaritje reflektive.
- Mund të ndodhin ndryshime në ngjyrën e Sikagard®-720 EpoCem® të paizoluara nga ekspozimi në rrezatim diellor të drejtpërdrejtë. Megjithatë, kjo gjë nuk ndikon në vetitë mekanike.
- Kur bëhet mbiveshje me veshjet PMMA, sipërfaqja e Sikagard®-720 EpoCem® duhet të spërkatet plotësisht me rërë 0.4-0.7 mm.
- Efekti TMB tek EpoCem® është i kufizuar në kohë, pa

përgatitje shtesë.

- Verifikoni gjithmonë përmbajtjen e lagështisë së sipërfaqes nëse kanë kaluar më shumë se 5-7 ditë nga aplikimi.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-720 EpoCem®

Qershor 2019, Botimi 01.01

020302050070000001

Sikagard-720EpoCem-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf